



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice**

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 168 /2024  
Datë: 12/07 /2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, si dhe në përputhje me nenin 6 (paragrafi 1, 2 dhe 6) të Rregullores QRK - nr. 15/2024 për klasifikimin, ndryshimin e statusit të klasifikimit, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komisioni për Përpilimin e Listës së Informacionit të Klasifikuar në këtë përbërje:

- 1.1. Ridvan Hoti-Ud. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Trajtim-Kryesues;
- 1.2. Bergita Curri zv. Udhëheqëse për Cilësi, anëtare;
- 1.3. Gazmend Citaku-Drejtor i Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar anëtar;
- 1.4. Adea Geci- Udhëheqëse e Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara anëtare;
- 1.5. Ardian Mehmeti Zv. Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, anëtar.

2. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tij t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi është i obliguar që brenda afatit prej 2 muajve, të përpilojë listën e informacionit që do të klasifikohet brenda Ministrisë së Drejtësisë, e cila i dërgohet Autoritetit Klasifikues.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 102 /2014 i datës 14.07.2014.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



*Vendimi i'u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*